

Fier me 03.12.2015

Drejtuar: AKM-Tirane

Per Dijeni: DRM-Fier

Bashkise Libofsh, Qarku Fier

LENDA: KERKESE PER PJESEMARRJE NE ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B: BLEKTORIA, ID 7.8, d. RRITJE INTENSIVE E GJEDHIT NË NJË INSTALIM

SUBJEKTI : PERSONI JURIDIK TRIS ALB

ADMINISTRATORE: ZNJ. SANIE LALAJ

ADRESA : FIER LIBOFSH LIBOFSH RRUGA LLAQI JANO, NDERTESE 1 KATESHE NE LIBOFSH, FIER

FIER 2015

AKTIVITETI: BLEKTORIA, ID 7.8, d. RRITJE INTENSIVE E GJEDHIT NË NJË INSTALIM

PERSONI JURIDIK TRIS ALB ME NR NIPTI L02003025P

ADRESA : FIER LIBOFSH LIBOFSH RRUGA LLAQI JANO, NDERTESE 1 KATESHE NE LIBOFSH, FIER

Subjekti ka disa vite qe ushtron aktivitetin ne keto stalla per rritjen intensive te gjedhit. Ne afersi te zones ku zhvillon aktivitetin subjekti nuk ka shkolla ,vepra arti,argjinatura,linje eletrike dhe linje uji qe mund te demtohen nga zhvillimi i aktivitetit nga subjekti.

Permiresimi urban i kesaj zone, e cila ka patur zhvillime mjaft te medha e te shpejta , urbanistike dinamike kohet e fundit vazhdon te terheq mjaft interesin e subjekteve privat.

Hapsira para nderteses se stalla per rritjen intensive te gjedhit eshte e sistemuar , dekoruar me lule duke bere te mundur realizimin e nje imazhi pamor mjedisor shume cilesor ,cka dhe ka ndikuar ne permiresimin e pamjes vizuale.

Pervec interesit ekonomik , investitori ka bere rregullime ,sistemime te sheshit para objektit, rrugeve, ka krijuar hapsira te gjelberta.

Aktiviteti Stalle per rritjen intensive te gjedhit është një ndërtesë me hapësirën e nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti. Duhet theksuar që subjekti ka disa vite që e ushtron këto aktivitete në këto ambiente dhe nuk ka patur asnjehere probleme me komunitetin dhe sipërmarrësit që kanë aktivitetet pranë Rritjen intensive të gjedhit për majmeri dhe tregëtimin e tyre (Stalla për rritjen intensive të gjedhit).

Teritori i zgjedhur është mjaft i përshtatshëm për funksionimin e këtij aktiviteti duke paraqitur disa përparësi si:

- Sistem perspektiv të furnizimit me rrush si lende e parë
- Sistem perspektiv të furnizimit me energji elektrike.
- Mundësi për zbatimin korrekt të projektit

- Mundesi per ngritje te sistemit te kanalizimeve dhe shkarkimeve.
- Ka qene stalle ekzistuese dhe ka patur te njejtin funksion

Pozicioni i rritjes intensive te gjedhit per majmeri dhe tregetimin e tyre ka te zgjidhura disa nga problemet qe lidhen me anen funksionale si.

- Largesia te mjaftushme nga vendet e banuara.
- Prane fuqise punetore.

Aktiviteti Stalla per rritjen intensive te gjedhit ku zhvillohet aktiviteti eshte me nje kate, e pajisur me leje ndertimi.

Siperfaqja e stabilimenteve ekzistuese jane:

Stalla 1 - 1846 m²

Stalla 2 - 1420 m²

Stalla 3 - 2542 m²

Hangari i mjeteve - 960 m² .

Numri i krereve per te gjitha projektin e stallave te cilin kemi synim te arrijme eshte 600 krere.

Ne te operojne teknologjia dhe instalimet perkatese, ambjentet e sherbimeve mbeshtetese dhe parkimi.

Per rritjen e gjedhit per majmeri dhe tregetimin e tyre perdoren ushqime te certifikuara. Stalla pastrohet gati cdo dite dhe jashteqitjet perdoren per pleherimin e tokave te mbjella me jonxhe qe sherbejne si ushqim per gjedhin. Pra te gjitha mbetjet qe dalin nga larja dhe pastrimi i stalles futen ne nje grope prej betoni dhe prej ketej merren me bote dhe pleherohet tokat e mbjella me jonxhe.

AKTIVITETI TREGTAR AKTUAL

Shoqeria TRIS - ALB ka nje kompleks gjedhi per qumesht dhe per rrjedhoje produkti i tij kryesor eshte qumeshti, por njekohesisht ai tregton edhe nje pjese te vicave te lindur; kryesisht ata meshkuj. Qumeshti qe ai tregton eshte i kontraktuar nga

kompania e perpunimit “LUFRA”, dhe produkti tregtohet menjehere pas mjeljes se lopeve. Transporti behet me cisterna inoksi qe jane pronesi e kompanise se perpunimit “LUFRA”. Vicat meshkuj si edhe ndonje vic femer qe nuk ka tregues te mire per remont tregtohen menjehere mbas lindjes se tyre.

Shoqeria TRIS - ALB ka gjithsej 400 krere lope qumeshti (synimi eshte te arrijme rreth 600 Lope) ne prodhim dhe realizon nga ato nje prodhim total vjetor 546 ton qumesht me nje rendiment mesatar rreth 7800 litra per lope ne laktacion. Ai ka nje kontrate vjetore per shitjen e prodhimit me kompanine “LUFRA”.

Per shitjen e prodhimeve te veta shoqeria TRIS - ALB ka marreveshje me kompanine e perpunimit te qumeshtit “LUFRA” dhe i qendron ne menyre korrekte kesaj marreveshje per te gjithë periudhen e vitit edhe pse disa kompani te tjera te perpunimit te qumeshtit kane interes te blejne produktin e tij. Persa i perket shitjes se vicave shoqeria TRIS - ALB ka kontakte me fermere te ndryshem ne zonen e Libofshes (aty ku shoqeria TRIS - ALB ka edhe kompleksin e vet) qe blejne vica te sapolindur per te i rritur ata per prodhim mishi. Keta fermere vijne aty rregullisht (sipas edhe kalendarit te pjelljeve) per blerjen e vicave.

Tregu i produkteve blegtorale eshte nje treg ne rritje dhe per pasoje ka gjithmone e me shume te pranishme konkurencen. Specifika e prodhimeve blegtorale ne Shqiperi eshte se ai vjen ne shumicen derrmuese te tij nga ferma shume te vogla blegtorale (mesatarisht 3-5 lope qumeshti per ferme blegtorale). Kjo madhesi ferme (3-5 krere lope) rrit ndjeshem koston e prodhimit dhe njekoheesisht veshtireson mireadministrimin e saj. avantazhi qe ka shoqeria TRIS - ALB me nje ferme shume me te madhe se sa mesatarja e vendit i jep atij shume perparesi qe kane te bejne jo vetem me koston e produktit por edhe avantazhe ne tregtimin e produktit te vet. Te gjithë perpunuesit e qumeshtit kane interesin per te patur te kontraktuar furnitore prodhues te medhenj si shoqeria TRIS - ALB.

Konkretisht shoqeria TRIS - ALB ka nje biznes relativisht te ri. Ajoe ka filluar kete aktivitet ne vitin 2012 me blerjen e 15- krere lopeve te races “Hollshtej” dhe qe nje

vit me pas e ka dyfishuar numrin e krereve duke blere edhe 300 krere lope te tjera po te races "Hollshtej" te gjitha te blera ne Hollande. Nga lindjet e para shoqeria TRIS - ALB ka rritur edhe 100 krere meshqerra te cilat brenda ketij viti (ne tremujorin e fundit te v.2014) pjellin per here te pare.

- Per te realizuar prodhimin e mesiperm te qumeshtit dhe mishit aktualisht shoqeria TRIS - ALB ka nje kosto si me poshte:

- 1- Prodhim jonxhe (18 ha) 270 ton bar i thate. Kosto totale per kete prodhim = 1.329.300 leke
- 2- Silazh misri (20 ha) 900 ton. Kosto totale per kete prodhim = 1.070.000 leke.
- 3- Lolium (13 ha) 390 ton. Kosto totale per kete prodhim = 778.700 leke
- 4- Koncentrate blerje (miser, bersi, hime etj) 141 ton = 7.108.176 leke
- 5- Shpenzime te tjera direkte (energji elektrike, sherbim veterinar, pagat e punonjesve, materiali biologjik, karburant, qera toke etj) = 7.159.800 leke
- 6- Shlyerje kredie = 3.000.000 leke
- 7- Shpenzime totale = 20.445.976 leke

Te ardhurat neto vjetore qe realizohen nga ky biznes jane 10.361.024 lek.

STRUKTURA E PRONËSISË

Kompleksi i mbareshtimit te lopeve teshoqerise TRIS – ALB eshte i ndertuar ne nje siperfaqe toke prej 1.6 ha e cila eshte pronesi e shoqerise TRIS – ALB.

Shoqeria TRIS – ALB ka te vetat objektet si stalla e lopeve, hangari i barit si edhe nje mekanike bujqesore qe perbehet si me poshte:

- 1- Mjelse mekanike per 6 krere ne nje process mjeljeje.
- 2- Stativ per insiminimin artificial te lopeve

- 3- Bote (cistern) plehu
- 4- Bote (cistern) qumeshti
- 5- Kositese jonxhe
- 6- Mishelator ushqimesh
- 7- Zetor (3 cope) me fuqi te ndryshme motorike
- 8- Autokombajne per silazh
- 9- Agregate te ndryshme bujqesore si plyg, freze, makine mbjellese etj.

Hangari i cili sherben per magazinimin dhe ruajtjen te dengjeve me bare jonxhe, bar lulumi dhe koncentre te ndryshme te paketuara ne thase te cilat kane problem me lageshtiren dhe qe mund te sjellin myqe te cilat ndikojne negativisht ne shendetin e kafsheve, ka nje siperfaqe prej 960 m². Lartesia e tij eshte 5 m. Ky hangar eshte i ndertuar sipas standarteve dhe krijon kushte shume te mira per ruajtjen e ushqimeve te thata dhe te koncentruara nga demtimet e agjenteve natyrore por njekohesisht i mbron ato nga mikrobet e ndryshme qe mund te u krijoheshin ne ambiente te hapura. Stalla e lopeve te qumeshtit sherben si vend qendrim per keto lope qumeshti per mjelien e tyre si dhe per mjekimin nese do te shfaqin probleme shendeti. Kjo stalle sic u lart permend eshte e pajisur edhe me nje padok (oborr) i cili sherben per ecjen ne gjendje te lire te lopeve nen driten e diellit e cila ka ka vitaminen E te nevojshme tek lopa sidomos per procesin e riprodhimit. Stalla ka parametra bashkekohore dhe eshte e ndertuar sipas nje modeli te avancuar Hollandez.

Gropa e silazhit eshte nje nga objektet e ndertuara po me parametra bashkekohore me nje kapacitet mbajtes prej 800 ton silazh.

BURIMET NJERËZORE

Shoqeria TRIS – ALB ka te punesuar 7 punonjes gjithvjetor si edhe rreth 25 te tjere te punesuar sezonal. Puntoret qe jane te punesuar per te gjithë vitin jane ata qe punojne ne kompleksin e lopeve kurse ata sezonale punojne (sipas nevojave) ne periudhen e kultivimit te foragjereve, ne periudhen e korrjes dhe te pregatitjes se ushqimeve per bar te thate apo silazh. Fuqia puntore vjen nga zonat perreth kompleksit te blegtorise dhe per te dyja kategorite e fuqise puntore ata jane te njejtë, per faktin sepse interesat

e te dy paleve perputhen. Puntoret kane interesin e ruajtjes se mundesise se punesimit (ne kete zone eshte e veshtire te punesohesh ose te vetepunesohesh, sepse eshte zone e "izoluar" nga pjesa urbane), por edhe shoqeria TRIS – ALB ka interes te kete te njejten fuqi puntore sepse ka investuar ne kualifikimin e tyre.

Shoqeria TRIS – ALB ka nje kapital te qendrueshem te perbere nga keto asetete:

- 1- Toke 1.6 ha ne pronesi te familjes Lalaj me titull pronesie per znj. Sanie Lalaj. E gjithë kjo siperfaqe toke eshte e destinuar per ndertimin e te gjithë infrastruktures se kompleksit te lopeve qe eshte ndertuar dhe qe do te vijoj te ndertohet mbeshetur ne nje projekt plan zhvillimi qe shoqeria TRIS - ALB ka ne lidhje me kete biznes.
- 2- Agregate dhe makineri bujqesore dhe blegtorale qe jane pershkruar edhe me larte dhe qe kane nje vlere rreth 12.000.000 lek.

Shoqeria TRIS – ALB nepermjet ketij investimi synon mbi te gjitha qe te kompletoje te gjithë biznesin e vete me te gjitha normat dhe standartet qe aplikohen ne feramat blegtorale perendimore. Te gjitha keto investime kane nje ndikim indirekt edhe ne cilesine e prodhimit te qumeshtit ne pastertine e tij nga mundesia e ngarkesave mikrobike etj.

Produktet blegtorale jane produkte te kerkuara ne treg. Ne si vend (Shqiperia) jemi deficitare ne keto produkte krahasuar me nevojat qe ka tregu. Nje pjese e mire e produkteve te fresketa si qumesht dhe mish jane produkte importi dhe per sa i perket produkteve blegtorale te perpunuara pothuajse dominojne produktet e importit ose edhe ne rastin kur perpunimi eshte ne vendin tone; lenda e pare eshte e importit. Produktet blegtorale me origjine shqiptare jane shume me te kerkuara ne treg krahasuar me ato te importit. Pikat e grumbullimit dhe te perpunimit te qumeshtit jane ne kerkim te njesive te medha prodhuese te qumeshtit per faktin se kontraktimi i lendes se pare ne me pak pika u jep mundesine atyre per te ulur koston ne grumbullimit dhe njekohesisht rrit cilesine e prodhimit te tyre.

- Cmimi i shitjes se produkteve blegtorale (qumesht dhe mish) ne keto vitet e fundit ka nje dinamike rritjeje te lehte progresivisht dhe te qendrueshme. Sigurisht qe cmimi i shitjes se produktit lidhet shume me cilesine e tij. Mbareshtimi i lopeve te racave te specializuara per qumesht si ne rastine e shoqerise TRIS - ALBsi edhe perdorimi i racioneve ushqyese te balancuara ben te mundur nje prodhim qumeshti mjaft me cilesor krahasuar me rastet kur ky prodhim vjen nga ferma te vogla blegtorale te cilat ne shumicen e tyre nuk mbareshtojne kafshe me kapacitet gjenetik te larte dhe nuk mundesojne nje te ushqyer te ballancuar gjithvjetor per arsye te mungeses se infrastruktures per kete qellim.
- Per te patur me shume siguri ne shitjen e prodhimeve te veta shoqeria TRIS - ALB ka te kontraktuar shitjen e te gjithë prodhimit te qumeshtit me

kompanine “LUFRA”. Kjo lidhje kontraktuale eshte vendosur qe ne fillimin e biznesit blegtoral nga ana e shoqeris TRIS – ALB dhe vazhdon normalisht per faktin sepse te dy palet kane interesa te perbashketa. “LUFRA” ka interesin e ndertimit te marrdhenieve me ferma te medha sepse i ne kete menyre i mundesohet nje furnizim ritmik i fabrikes se vet dhe njekohesisht cilesia e produktit dhe siguria ushqimore per kete produkt me ferma te tilla si shoqeria TRIS – ALB eshte shume e larte.

- Konkurent te shoqeris TRIS - ALB jane te gjitha prodhuesit e qumeshtit dhe mishit qe zhvillojne aktivitetin e vete ne Komunen e Libofshes si edhe me tej, por fakti se keta prodhues mbareshtojne tufa te vogla (5 deri ne 15 krere) i jep avantazhe shume te ndjeshme shoqeris TRIS – ALB per te qene nje klient i preferuar i te gjitha fabrikave te perpunimit te qumeshti. Po keshtu ne lidhje me shitjen e vicave (kryesisht ata meshkuj) ka nje interes te dukshem nga ana e fermereve qe kane si drejtim e vet rritjen e vicave per mish. Keta fermere shpesh (duke ditur edhe grafikun e pjelljeve) mbajne lidhje me shoqerine TRIS - ALB per te ardhur ne momentin e duhur ne kete kompleks. Cmimi i shitjes se mishit peshe e gjalle (per vicat ne rritje) sigurisht qe eshte me e larte se ai kur ata shiten per therje.
- Shoqeria TRIS – ALB ka informacionin e plote per situaten e cmimeve te tregut dhe njekohesisht e ndjek ecurine e cmimeve, per te negociuar ne momentin e duhur me bleresit ne rast te rritjes se mundshme te cmimit. Shoqeria TRIS – ALB eshte ne kontakte te vazhdueshme me sherbimin e ekstensionit te ofruar nga shteti, dhe te gjitha informacionit qe buron nga strukturat e informacionit te shtetit.

Ne ditet e sotme projekti te cilin ne paraqesim i ofron kafsheve te gjitha kushtet kryesore dhe optimale per lopet dhe meshqerrat si: drite, uje, ajer i fresket dhe i paster si dhe pastertia brenda ne kompleks.

Te gjitha keto do ti argumentojme me poshte per te dhene nje ide me te qarte te investimit.

Pesa i perket drites, ambjertet jane te hapura anesore, me nje panel polikarbonati ne pjesen e catise per te patur sa me shume drite natyrale (drite dielli), dhe njekohesisht vendqendrimet e kafsheve jane te pajisura me nje padok, i cili u mundeson kafsheve ecjen dhe ndenjen e lire ne ambient natyral, dmth jashte objektit ku ato flene dhe ushqehen.

Persa i perket ujit i cili eshte nje faktor teper i rendesishem ne prodhimtarine e larte dhe mirqenien e meshqerrave dhe lopeve, uji i cili perdoret per kafshet vjen nga

tubacionet e ujit te pishem te UKF sipas nje kontrate te rregullt lidhur ne komune. Edhe ajrimi eshte i plote dhe i vazhdueshem gje qe e mundeson projekti i ndertimit. Pastertia eshte problem i rendesishem ne nje kompleks blegtoral, te cilin ne jemi munduar ta sjellim nepermjet projektit europian te kompleksit. Mjafton te permendim se stalla eshte e pajisur me gropa septike per kullimin dhe konservimin e plehut organik i cilin ne momentin e duhur do te perdoren per pleherimin e tokave qe jane ne dispozicion te kompleksit blegtoral per furnizimin me ushqim per kafshet per gjate gjithë vitit.

Ambientet e Punes dhe ato sanitare pastrohen jo me pak se nje here ne dite dhe ne raste te vecanta me shume, dhe mbas cdo pastrimi behet dizifektimi i saj.

Uji qe ne perdorim vjen nga ndermarja e ujesjellesit te Uk-Libofsh dhe kemi kontrate te rregullt me kete ndermarrje.

Aktiviteti zhvillohet ka kohë që ekziston dhe nuk ka patur asnje problem me komunitetin dhe nuk ka shkaktuar probleme të ndotjes së mjedisit.

Me këtë raport sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Aktiviteti jone ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Ne Stalla per rritjen intensive te gjedhit jane punesuar 7 punonjes te perhershem dhe 25 me kontrate.

Nga pikpamja sociale, zhvillimi i ketij aktiviteti eshte faktor per zbutjen e papunesise dhe burim te ardhurash per familjet qe jetojne duke punuar ne kete shoqeri.

Në territorin përreth objektit infrastruktura inxhinjerie është në gjendje të mirë, rrugët janë të shtruara, sipërfaqet e lira janë të gjelbëruara me pemë dekorative, sistemi i kanalizimeve, rrjeti elektrik dhe ujësjellësi janë në gjendje të mirë.

Arsyet për përzgjedhjen e këtij vendi për të kryer aktivitetin ZNJ. SANIE LALAJ janë:

- Aktiviteti Stalla per rritjen intensive te gjedhit ndodhet në një vend startegjik për zhvillimin e aktivitetit.
- Aktiviteti Stalla per rritjen intensive te gjedhit ndodhet në një zonë qe nuk dëmton Komunitetin.
- është me dalje në rrugë si dhe ekziston infrastruktura e nevojshme: rrugë, energji, ujë, sistem kanalizimesh, etj.
- është në largesi nga komuniteti.
- Ka qene stalle ekzistuese.

Përshkrimi i mjedisit fizik të zonës

Klima

Në zonën ku do të do të zhvillojë aktiviteti Stalla per rritjen intensive te gjedhit, klima është me dimër të ftohte dhe verë të nxehtë.

Në këtë zonë mbizoterojnë erërat e veriut dhe me drejtim nga veri – perëndimi për në jug – lindja, me shpejtësi mesatare 5 m / sekondë.

Diellëzimi. Zona ka mbi 2627 orë diell / vit, janari ka rreth 121 orë / vit dhe korriki rreth 357 orë / vit.

Zona ka pasuri të mëdha klimatike, që shprehen në pasuritë e konsiderueshme termike: vlera të larta të temperaturave mesatare, zgjatjen e madhe e periudhës me temperature $\geq 10^{\circ}\text{C}$, në rastet e rralla me ngrica dhe periudhën e shkurtër të shfaqjes së tyre. Në dimër deri 7°C deri në 2°C , në pranverë 18°C , në verë 30°C dhe në vjeshtë 17.3°C .

Pasuritë pluviometrike: mesatarisht mbi 1250 litra për m^2 të sipërfaqes, vlerat e larta të diellëzimit me rreth 2600 orë në vit etj.

Gjeomorfologjia

Ekosistemet kodrinore të rajonit nga pikëpamja gjeologo-tektonike bëjnë pjesë në Ultësirën Pranë - Adriatike. Kryesisht mosha gjeologjike e ekosistemeve kodrinore të rajonit daton që para 15 milion vjetësh (Serravalian).

Evucioni gjeologo-tektonik që kanë ndjekur këto rajone, ka kushtëzuar dhe elementet strukturor si: monoklinale, antiklinale, sinklinale , etj.

Nga ana stratigrafike rajoni ndërtohet kryesisht nga depozitime Neogjenike. Moshat më të vjetra dhe më të reja gjeologjike të pranishme në rajon janë Burdigaliani, Langiani, Seravaliani, Tortoniani dhe Mesinian.

Copëtimi horizontal i relievit lëkundet nga 1-5 km /km². Ato rriten në drejtim të pjesës qëndrore më të lartë të territoreve argjilore të zonës dhe pranë qendrave të banuara rurale.

Copëtimi vertikal i relievit merr vlera të vogla deri nëmesatare, nga rreth 50 ne 200 m/km². Kjo lidhet me përbërjen litologjike dhe amplitudën jo të madhe të lëvizjeve ngritëse neotektonike. Vlerat më të vogla i takojmë në rrethinat e zonës, sidomos në rrethinën fushore lindore dhe perëndimore, ndërsa në atë jugore dhe veriore kanë shtrirje shumë më të kufizuar. Vlerat më të mëdha takohen në qendrën më të lartë të zonës dhe sidomos përgjatë fronteve të kuesteve apo kreshtave monoklinale.

Pjerrësia e shpateve merr vlera të ndryshme, më të mëdha (rreth 20-30 %) në shpatet e sektorit jugor dhe verior si dhe në frontet e kuesteve e kreshtave monoklinale, ndërsa vlerat më të ulta (deri në 10-15 %) takohen në rrethinat, sidomos perëndimore dhe lindore dhe në pjesën e poshtëme të pellgjeve lumore të zhvilluara në depozitime argjilore.

Përqindjen më të madhe e zënë shpatet me orientim perëndimor së bashku me shpatet jugore dhe jugperëndimore. Ato janë edhe më të ngrohtë, më të dritësuar dhe përbëjnë oferta të rëndësishme për shfrytëzimin e tyre për vendosjen e qendrave turistike apo kultivimin e bimëve termofile dhe heliofile.

Në këtë zonë përhapjen më të madhe e ka relievi strukturoro-eroziv dhe erozivo-denudues, të cilët ndërthuren në rrethinat edhe me forma të veçanta të relievit lumor.

Relievi strukturoro - eroziv, i lidhur me strukturën monoklinale dhe ndërthurjen e formacioneve me fortësi të ndryshme, përbehet nga disa kreshta monoklinale, kueste, sipërfaqe dhe lugina strukturore.

Relievi eroziv është i lidhur me proceset erozivo – denuduese, të cilat janë ndër

faktorët kryesorë aktual që luajnë rol të rëndësishëm në modelimin e relievit. Intensiteti i tyre është i lidhur me kushtet e favorshme natyrore për zhvillimin e proceseve të erozionit dhe shpatit. Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tyre ka luajtur aktiviteti i njeriut mbi mjedisin dhe sidomos mbi bimësinë dhe tokat në veçanti.

Rezervat ujore

Ndërthurja e pakove ranore e konglomeratike me ato argjilore i ka dhënë mundësi grumbullimit në sasira të konsiderueshme të ujrave nëntokesorë (akuiferet e Tortonianit, Mesinianit dhe Kuaternarit). Për këtë flasin pusët e shumta të hapura kohët e fundit nga vete fermeret dhe pusët e thella të hapura nga hidrogeologjia para vitit 1990, që furnizonin të gjitha qendrat e banuara me ujë të pijshëm nëpërmjet ujësjellsave të ndërtuara në vite të ndryshëm. Për fat të keq këta ujësjellsa aktualisht nuk funksionojnë, prandaj edhe fermerët janë detyruar të hapin vetë puse të cekët (deri 10 m) për të siguruar ujin për nevojat e tyre. Kjo pasuri jo e vogël, në kushtet kur në sipërfaqe, siç theksuam, rezervat ujore janë tepër të kufizuara, duhet të vleresohet në strategjitë dhe planet e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës Shkoder.

Tokat

Tokat në këtë zonë janë të hinjta kafe dhe të kafenjta. Ato shtrihen në formën e brezave vertikale deri në lartësitë më të mëdha të zonës.

Ky ekosistem zë një pjesë të mirë të kësaj hapësire dhe në pjesën më të madhe shtrihet në zonën e ulët dhe kryesisht pranë zonave të banuara. Ai përfaqësohet kryesisht nga tokat e mbjella me kultura të ndryshme bujqësore dhe nga pemët drufrutore të cilat janë mjaft të përhapura në këtë hapësirë.

Flora e tokave të kultivura është në përgjithësi e varfër dhe monofite, e përfaqësuar kryesisht nga të lashtat dhe kulturat prashitëse.

Sipërfaqet boshe

Këto habitate në këtë zonë zënë sipërfaqe të vogla dhe janë kryesisht në pjerrësit e

kodrave, të përfaqësuara nga pjesët shkëmbore dhe pjesët e eroduara. Këto sipërfaqe janë pothuajse teërësisht të zhveshura nga bimësia fanerogamike.

Në sipërfaqet shkëmbore takohen kryesisht përfaqesues nga flora Likenike, Briofitike dhe nga disa Pteridofite.

Biodiversiteti

FLORA

Fizionomia floristike e kësaj zone përcaktohet nga shkurreta me gjethe gjithnjë të blerta dhe nga shkurreta gjethe rënëse. Në zonen ku gjendet aktiviteti Stalla për rritjen intensive të gjedhit është zone me pamje Industriale dhe bimesia është e përbërë nga bime dekorative, shkurre dhe pemë dekorative të mbjella nga bizneset.

Fauna

Numri i Amfibeve të zonës është 10, afro 60% e llojeve të Amfibëve që jetojnë në Shqipëri. Ndërsa numri i reptileve të vrojtuar deri më sot është 25 lloje, rreth 70% të Reptilofaunes që takohet në Shqipëri. Numri i Amfibëve dhe Reptileve konsiderohet i lartë dhe shpreh gjithashtu shkallën e lartë të biodiversitetit të zonës.

Një numër i lartë llojesh është i rrezikuar në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Nga krahasimi i listës të llojeve të Amfibëve e Reptilëve me listën e kuqe të Shqipërisë (Libri i Kuq, 1997) dhe anekset e disa konventave ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë, rezulton se një numër i konsiderueshem i këtyre llojeve, të pranishme në zonat kodrinore të LIBOFSH ss, u perkasin llojeve të rrezikuara në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Kjo dëshmon për rëndësinë e zonës në studim në nivel kombëtar, Mesdhetar e më gjerë.

Ndikimet në mjedis

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbëtjeve të rrezikshme
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikoj në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonën ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta, ujerat e larjes se stalles dhe ambienteve dekantohen.
- Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
- Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.
- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth.
Niveli i zhurmës nuk i kalon 55-60 dB(A) gjatë punës në këto stalle. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.
- Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.
- Trafiku rrugor. Gjatë këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikime në aktivitetin rrugor.

- Projektet e tjera si: rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, linja të energjisë, naftë dhe gazsjellës, linja të telekomunikacionit etj. nuk do të ndikohen nga aktiviteti i stalles.

Aktiviteti Stalla per rritjen intensive te gjedhit pastrohet rregullisht brenda dhe jashte. Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Ky nivel zhurmash nuk ndikon në shëndetin e punonjesve dhe as në shëndetin e personave që punojnë në ambjentet përreth .

Punonjësit e kësaj Stalle per rritjen intensive te gjedhit janë udhëzuar të bejnë një përdorim të duhur të ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike. Ata janë tepër të kujdesshëm për një përdorim sa më të përshtatshëm të këtyre dy burimeve.

Masat mbrojtëse për punonjësit

Punëtorët janë të pajisur me librezat shëndetësore përkatëse.

Mbrojtja në punë dhe ruajtja e shëndetit të punonjësve që punojnë në magazinën e perpunimit te ullirit realizohet duke zbatuar:

- Rregulloren e sigurimit teknik
- Normativat e ndotësve në mjediset e punës të miratuara nga Inspektoriati i Higjenës së Punës
- Garancinë e produkteve që ruhen në Stalle per rritjen intensive te gjedhit si të padëmshme për shëndetin e punëtorëve në të gjitha fazat e punës me to.

Konkluzione

Personi Juridik Tris Alb ne Stalla per rritjen intensive te gjedhit do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe do të investojë për përmirësimin e mjedisit, punës dhe do të mirëpresë cdo sygjerim në të mirë të cilësisë së punës, si dhe aktiviteti do të bëjë të mundur zbutjen e papunësisë në këtë zonë, duke punësuar një pjesë të mirë të banorëve të kësaj zone.

Aktiviteti Stalla per rritjen intensive te gjedhit nuk gjendet ne Shtojcen per proceduren e VNM paraprake ose te thelluar te Ligjit Nr 10 440 për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis, datë 7.7. 2011, per me teper qe ky subjekt eshte stalle ekzistuese dhe eshte Instalim Ekzistues dhe nuk ka nevojë qe te ndertoje stalle te re dhe te marri leje ndertimi dhe nuk ka ndryshuar as vendodhjen, as kapacitetet dhe as siperfaqen. Ne Perputhje me VKM nr. 419 date 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja , ky subjekt duhet te aplikojë per leje mjedisi të tipit B ne AKM-Tirane.

Adresa e AKM-se, ku publiku mund te dergoje komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo ne forme Elektronike:

Adresa: Rruga "Sami Frasheri" Nr.4, Tirane, - Tel/Fax 04 2 371 237 www.akm.gov.al

Konform te te gjitha akteve dhe procedurave ligjore ne fuqi i drejtohem AKM-Tirane per ndjekjen e procedures konsultimit me publikun dhe palet e interesuara per aplikimin per LEJE MJEDISI TE TIPIT B:

AKTIVITETI: BLEKTORIA, ID 7.8, d. RITJE INTENSIVE E GJEDHIT
NË NJË INSTALIM

PERSONI JURIDIK TRIS ALB ME NR NIPTI L02003025P

ADRESA : FIER LIBOFSH LIBOFSH RRUGA LLAQI JANO, NDERTESE 1
KATESHE NE LIBOFSH, FIER

ADMINISTRATORE

SANIE LALAJ

Celular; 0697574420 & 0695141396

